



Këtë javë në komisionet parlamentare

■ **U shqyrtuan 4 nisma ligjore të rëndësishme:**

• **Projektligjet:**

- “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”
- “Për censin e popullsisë dhe të banesave”;

• **Projektvendimin** “Për shpalljen e vakancës së Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”;

• **Dekretin e Presidentit të Republikës** nr.11812, datë 5.11.2020 “Për kthimin e ligjit nr. 130/2020 “Për një ndryshim në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile” të ndryshuar”.

Seanca plenare

■ Kuvendi miratoi tre projektligje

Kuvendi u mbledh në seancë plenare dhe miratoi projektligjet:

- “Për buxhetin e vitit 2021”

-“Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2019”

-“Për disa ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë politike”, i ndryshuar”,

Aktivite parlamentare

■ Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Vasilika Hysi, mori pjesë në ceremoninë përkujtimore të 76 jetorit të çlirimit të Tiranës

17 Nëntor 2020 - Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Vasilika Hysi, mori pjesë në ceremoninë përkujtimore të 76 vjetorit të çlirimit të Tiranës. I pranishëm ishte dhe zv. kryeministri z. Erion Braçe, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj, deputetë, anëtarë të Këshillit Bashkiak, si dhe dhjetëra veteranë të Luftës Nacional-Çlirimtare, të cilët nderuan partizanët, çlirimtarët e Tiranës, dhe dëshmorët që dhanë jetën për liri. Nënkryetarja e Kuvendit, znj. Vasilika Hysi, në fjalën e saj nënvizoi se vlerat e antifashizmit, progresit dhe të lirisë përbëjnë rrënjët e Shqipërisë së sotme demokratike dhe qëndrojnë në themel të kontributit tonë në aleancën e fuqishme atlantike të NATO-s dhe përpjekjeve tona për t'iu bashkuar familjes evropiane. “Ne, socialistet shqiptarë, por edhe çdo qytetar atdhetar, u jemi dhe do tu jemi përjetë mirënjohës partizanëve, këtyre patriotëve dhe çlirimtarëve të Shqipërisë. Ata janë kalorësit e lirisë dhe vepra e tyre nuk mund as të mohohet, as të errësohet, as të përvetësohet, në asnjë rrethanë dhe për asnjë arsye”, tha në fjalën e saj znj. Hysi.

■ Kuvendi zhvilloi takimin e radhës të Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut

21 Nëntor 2020 - Kuvendi i Shqipërisë nën drejtimin e zëvendëskryetares, znj. Vasilika Hysi, zhvilloi takimin e radhës së Rrjetit kombëtar për edukimin ligjor të publikut, të ngritur nën kujdesin dhe drejtimin e Kuvendit të Shqipërisë. Në fjalën e saj znj. Hysi vlerësoi punën e bërë nga Ministria e Drejtësisë dhe organizatat e shoqërisë civile për përgatitjen e planit të veprimit 2020–2023), në zbatim të Strategjisë së Edukimit Ligjor për Publikun, si pjesë e paketës së akteve ligjore të hartuara në kuadër të Reformës në Drejtësi dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave pak ditë më parë. Njëkohësisht znj. Hysi vlerësoi kontributin e Kuvendit, të ministrive të linjës dhe të Rrjetit kombëtar për edukimin ligjor të publikut gjatë konsultimit publik të planit të veprimit. Zbatimi i planit të veprimit do të mbulohet kryesisht nga buxheti i shtetit. Donatorë, organizatat e shoqërisë civile do të kontribuojnë gjithashtu në financimin dhe zbatimin e planit të veprimit. Ky fakt u vlerësua nga znj. Hysi dhe pjesëmarrësit në takim. Plani i veprimit i miratuar u prezantua nga zëvendësministja e Drejtësisë, znj. Adea Pirdeni. Në fjalën e saj u shpreh se: “Përmirësimi i kurrikulave të arsimit parauniversitar me njohuri ligjore të përshtatura sipas grupmoshës, rritja e kapaciteteve të institucioneve shtetërore për të ofruar informacion me njohuri ligjore për qytetarët, jetësimi i programeve specifike për edukimin ligjor të publikut dhe hartimi i materialeve informuese për ligjet me interes për publikun janë disa nga risitë e planit të veprimit”. Zbatimi i planit të veprimit do të monitorohet nga ministria e Drejtësisë, e cila do të raportojë në Kuvend. Duke vlerësuar rëndësinë e edukimit ligjor të publikut, pavarësisht vështirësive të gjendjes së fatkeqsisë natyrore dhe pandemisë së shkaktuar nga COVID 19, Kuvendi krijoi Rrjetin e edukimit ligjor të publikut, Komitetin drejtues të rrjetit, Bordin këshillor të përbërë nga përfaqësues të Kuvendit, të institucioneve të pavaruara, institucioneve përgjegjëse në fushën e informimit dhe edukimit ligjor, shoqëria civile dhe media.

Mesazhe urimi të Kryetarit të Kuvendit

Aksidenti në spitalin Covid në Rumani: Ruçi letër solidariteti kryeparlamentarit Çolaku

16 Nëntor 2020 - Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, i ka dërguar një mesazh solidariteti Kryetarit të Parlamentit të Rumanisë, z. Marçel Çolaku, pas tragjedisë së shkaktuar nga shpërthimi i zjarrit në spitalin Covid në qytetin Piatra Neamc të Rumanisë, ku humbën jetën disa paciente dhe u lënduan mjekë e infermierë.

“Me dëshpërim mora lajmin mbi aksidentin e shpërthimit të zjarrit në spitalin Covid në qytetin Piatra Neamc, si pasojë e të cilit humbën jetën dhjetë paciente dhe u lënduan disa mjekë e infermierë. Në emër të Kuvendit të Shqipërisë si edhe në emrin tim personal, Ju dërgojmë ngushëllimet tona të ndjera për familjet e viktimave si edhe mbështetjen e solidaritetin tonë për popullin mik rumun. Duke u lutur për shërimin sa më të shpejtë të pacientëve, mjekëve dhe infermierëve të dëmtuar, shprehim besimin se populli rumun do ta përballojë këtë fatkeqësi si edhe pasojat e tjera të shkaktuara nga pandemia. Shpreh gjithashtu bindjen se populli shqiptar, populli rumun si edhe të gjithë popujt e planetit do t’i përballojnë me forcë e kurajo pasojat e pandemisë së Covid-19 dhe do t’u kthehen sa më shpejt normalitetit dhe gëzimeve të jetës, punës, zhvillimit dhe mirëqenies.”, shkuan në mesazhin e tij Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi.

Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, përshëndet fëmijët e Shqipërisë me rastin e Ditës Botërore të Fëmijëve: Kujdes të veçantë për fëmijët gjatë pandemisë

20 Nëntor 2020 - Me rastin e 20 nëntorit, Ditës Botërore të Fëmijëve, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, u është drejtuar me një mesazh përshëndetës fëmijëve shqiptarë. “Me rastin e 20 nëntorit, Ditës Botërore të Fëmijëve, shpreh dashurinë, vëmendjen dhe impenjimin tim për 500 mijë fëmijët e Shqipërisë dhe prindët e familjet e tyre. Këtë vit, fëmijët shqiptarë, ashtu si edhe 2.3 miliard vërsnikët e tyre në të gjithë botën, e kremtojnë Ditën Botërore të Fëmijëve në kushtet e privacioneve, sakrificave dhe ankthit që ka shkaktuar pandemia e Covid-19. Urojmë e shpresojmë që bota të çlirohet sa më shpejt nga ky rrezik planetar, popujt t’i kthehen jetës normale dhe fëmijët librave, lojrave e argëtimeve, prej të cilave janë privuar prej rreth një viti. Sot është një ditë reflektimi dhe angazhimi për të investuar më shumë për fëmijët sepse kështu investojmë për të ardhmen. Sot është dita të nxisim e promovojmë të qenit bashkarisht për të mirëne fëmijëve tanë. Është dita e ndërgjegjësimit për të krijuar mundësitë që të gjithë fëmijët të gëzojnë të drejtat e tyre që u takojnë nga Konventa e të Drejtave të Fëmijës, adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara 31 vjet më parë, më 20 nëntor 1989, dhe ligjet e shtetit shqiptar. Është dita të mendojmë për përmirësimin e ligjeve, politikave dhe institucioneve tona, për të përmirësuar mirëqenien e fëmijëve. Të gjithëve na dhemb kur shohim fëmijët që detyrohen të punojnë për të jetuar, që përjetojnë apo vuajnë pasojat e abuzimit dhe të dhunës në familje apo jashtë saj. Prandaj sot është dita që të gjithë të ngremëzërin, të hartojmë ligje dhe të marrim vendime për të ndaluar abuzimin, dhunën dhe format e këqia të punës së fëmijëve. Të gjithëve na dhemb kur shohim fëmijë që braktisin shkollën. Asnjë arsye nuk e përligj këtë braktisje. Prandaj sot është dita që të gjithë, ligjvënësit, qeveria, shkollat dhe familjet, të marrim masat që të kthejmë në shkollë rreth 1500 fëmijët që braktisin çdo vit arsimin e detyrueshëm, dukuri që pandemia po e përkeqëson. Detyrën si Kryetar i Grupit të Deputetëve “Miq të Fëmijëve” e konsideroj si një ndër përgjegjësitë e mia më të larta dhe më fisnike në shërbim të vendit dhe të fëmijëve shqiptarë. Gjatë viteve të fundit, ky Grup ka inicuar nisma të rëndësishme për hartimin e akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen e të drejtave dhe përmirësimin e jetës së fëmijëve shqiptarë, sidomos për mbrojtjen e shëndetit të tyre fizik, mendor e social nga pandemia Covid-19.”, shkruan në mesazhin e tij përshëndetës Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi